



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**

DEGA VENDORE TIRANË

**NOTER MARIANA DAKA
ADRESA NJESIA BASHKIAKE NR. 5,
RR. EMIN DURAKU, AP. 3/1, KATI
PERDHE
TEL: 0692058147**

KONTRATA TË TJERA

(NDRYSHIM KONTRATA TE TJERA)

Nr. repertori: 1519

Nr. koleksioni: 794

Tirane më 23/08/2021


Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

*Akti noterial përbëhet nga 3 fletë



A2021053860092333963



A2021053860092333963

ANEKS I KONTRATËS
NR. 1418 REP. / NR. 725 KOL., DATË 30.07.2021

PËR FORMIMIN E SHOQËRISË SË THJESHTË



So, më datë 23 Gusht 2021, para meje Notere **MARIANA DAKA**, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NJESIA BASHKIAKE NR. 5, RR. EMËNDURAKU, AP. 3/1, KATI PERDHE, u paraqit personalisht:

THEMELUESIT

I Themelues në këtë kontratë janë dy shoqëritë e mëposhtme, të cilat marrin përsipër të krijojnë një Shoqëri të Thjeshtë në përputhje me këtë Kontratë dhe legjislacionin në fuqi.

1. **“ALBA BETON” SHPK**, me NUIS J62207004A, me seli në adresën: Petrele, Stermas, Njësia Administrative Petrelë, Fshati Stërmas, Tirane, përfaqësuar, sipas vendimit të Asamblesë së Shoqërisë, nga Administratori **Z. Erjon Harizi**, atësia Refat, amësia Xhezare, shtetas Shqiptar, lindur në Lumas, Berat dhe banues në TIRANË, me adresë Tish Daija; Nd. 23; H. 3; Ap. 52; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 19/10/1979, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033681362 dhe nr. personal H91019106G. përfaqësuar nga Administratori **Z. Adrian Dulaku**, atësia Niko, amësia Lirika, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Blv. Bajram Curri; Nd. 142; H. 1; Njësia Administrative Nr. 2; Njësia Bashkiake Nr. 2; 1003; Tiranë, lindur më 05/02/1960, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035240347 dhe nr. personal G00205223S. të dy madhorë dhe me zotësi të plotë për të vepruar, këtu më poshtë do të quhet **“PALA E PARË”**.

Dhe

2. **“BABASI COO” shpk**, i regjistruar si person juridik shqiptar, i regjistruar pranë QKB me NUIS J74517209B, me seli në adresën “Rruga kombëtare Fushë-Krujë – Krujë, km 2-të, Fushë-Krujë”, përfaqësuar, sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë datë 19.07.2021, nga administratori dhe ortaku i vetëm, **Z. Ndriçim Babasi**, atësia Bajram, amësia Sabije, shtetas Shqiptar, lindur në Fushë Krujë, Krujë dhe banues në Tiranë, me adresë Donika Kastrioti; Nd. 020; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 01/01/1967, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034813259 dhe nr. personal G70101309R, që këtu më poshtë do të quhet **“PALA E DYTË”**.

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura dhe të përfaqësuesve të tyre, Unë, noterja, konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, përkatësisht Nenit



A2021053860092333963

83, 659, 1074, e vijues të tij, bien dakord të hartojnë këtë KONTRATË sipas kushteve dhe kriterëve të mëposhtme:

DISPOZITA PARAPRAKE

A. Pala e Parë dhe Pala e dytë kanë nënshkruar, para noteres Mariana Daka, kontratën NR. 1418 REP. / NR. 725 KOL., datë 30.07.2021, për krijimin e Shoqërisë së Thjeshtë (Kontrata Ekzistuese).

B. Duke qenë se emri i përzgjedhur fillimisht nga palët (ALBA-INVEST) është i ngjajshëm me atë të një subjekti tjetër të regjistruar në regjistrin tregtar, sipas përfundimit të arritur nga specialistët e Qendrës Kombëtare të Biznesit, pas aplikimit për regjistrimin e Shoqërisë së re, palët bien dakord të bëjnë një ndryshim në Kontratën Ekzistuese për ndryshimin e emrit të Shoqërisë së Thjeshtë.

NENI 1

NDRYSHIMI I EMRIT

1. Palët bien dakord të ndryshojnë emrin e Shoqërisë së Thjeshtë nga "ALBA-INVEST" në "ALBA-INVESTIM" (Shoqëria e Thjeshtë), me adresë Rr: "Perlat Rexhepi" Nd. 1, H.14. NJA 5, Tiranë.
2. Në Kontratën Ekzistuese NR. 1418 REP. / NR. 725 KOL., datë 30.07.2021, të lidhur para Noteres Mariana Daka, për krijimin e Shoqërisë së Thjeshtë, kudo ku shkruhet emri i Shoqërisë së Thjeshtë, referuar si "ALBA-INVEST", do të zëvendësohet me "ALBA-INVESTIM".
3. Ky është ndryshimi i vetëm i bërë në Kontratën Ekzistuese.

NENI 2

1. Ky Aneks Kontrate është pjesë integrale e Kontratës Ekzistuese NR. 1418 REP. / NR. 725 KOL., datë 30.07.2021, të lidhur para Noteres Mariana Daka, për krijimin e Shoqërisë së Thjeshtë.
2. Çdo ndryshim tjetër i kësaj kontrate mund të kryhet vetëm me pëlqimin e të dy palëve/ortakëve themelues. Të gjitha shtesat dhe ndryshimet në këtë Kontratë, nuk do të kenë asnjë vlerë ligjore në qoftë se nuk janë miratuar dhe nënshkruar rregullisht nga të dyja palët.

Kjo kontratë e ruan fuqinë e saj ligjore dhe i shtrin efektet e saj edhe mbi trashëgimtarët e palëve kontraktuese apo të tretët, që mund të fitojnë të drejta reale mbi aktivitetin e tyre.

Kontrata, u lexua nga unë Noteri/ja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të palëve kontraktuese, të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse ajo shpreh vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.



A202105386092333963

Unë Noteri/ja, verifikova identitetin e palëve kontraktuese nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 të ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”, vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Ky Aneks Kontrate përbëhet nga 2 nene dhe 3 fletë dhe përpilohet në 5 (pesë) kopje të barazvlershme, në gjuhën shqipe.



PALËT THEMELUESE


TË SHOQËRISË SË THJESHTË “ALBA-INVESTIM”

PALA E PARE
“ALBA BETON” SHPK
Perfaqesuar nga:
ERJON HARIZI

PALA E DYTE
“BABASI COO” SHPK
Perfaqesuar nga:
NDRIÇIM BABASI

Erjon Harizi
[Signature]

Ndriçim Babasi
[Signature]



ADRIAN DULAKU

[Signature]
[Signature]

NOTERE
MARIANA DAKA



Mariana Daka
[Signature]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEPARTAMENTI I NOTERISË
DREKTORATI QENDRORE TIRANË

NOTER MARIANA DAKA
ADRESA NJESIA BASHKIAKE NR. 5,
RR. EMIN DURAKU, AP. 3/1, KATI
PERDHE
TEL: 0692058147

AKT MARRËVESHJE

Nr. repertori: 1418


Nr. koleksioni: 725

Tirane më 30/07/2021

Ligjet referuese



- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterë"

Akti notarial për bashkimin e 13 (13) qytetarëve



A2021053860079625872

PULLE TARIFE



PËR FORMIMIN E SHOQËRISË SË THJESHTË



Noterë me datë 30 Korrik 2021, para meje Notere **MARIANA DAKA**, anëtare në Dhomën Kombëtare Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NJESIA BASHIKIAKE NR. 5, RR. FERMIN DURAKU, AP. 3/1, KATI PERDHE, u paraqiten personalisht:

THEMELUESIT

I. Themelues në këtë kontratë janë dy shoqëritë e mëposhtme, të cilat marrin përsipër të krijojnë një Shoqëri të Thjeshtë në përputhje me këtë Kontratë dhe legjislacionin në fuqi.

1. **"ALBA BETON" SHPK**, me NUIS J62207004A, me seli në adresën: Petrele, Stermas, Njesia Administrative Petrelë, Fshati Stërmas, Tirane, përfaqësuar, sipas vendimit të Asamblesë së Shoqërisë, nga Administratori Z. Erjon Harizi, me banim në Tirane, mbajtës i dokumentit me numer personal H91019106G, si edhe Z. Adrian Dulaku, mbajtës i dokumentit të identifikimit me numër personal G00205223S, të dy madhorë dhe me zotësi të plotë për të vepruar, këtu më poshtë do të quhet **"PALA E PARË"**.

Dhe

2. **"BABASI COO" shpk**, i regjistruar si person juridik shqiptar, i regjistruar pranë QKB me NUIS J74517209B, me seli në adresën "Rruga kombëtare Fushë-Krujë - Krujë, km 2-të, Fushë-Krujë", përfaqësuar, sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë datë 19.07.2021, nga administratori dhe ortaku i vetëm, Z. Ndriçim Babasi, identifikuar me dokument identifikimi ID me nr. personal G70101309R, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, që këtu më poshtë do të quhet **"PALA E DYTË"**.

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura dhe të përfaqësuesve të tyre. Unë, noterja, konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, përkatësisht Nenit 83, 659, 1074, e vijues të tij, bien dakord të hartojnë këtë KONTRATË sipas kushteve dhe kriterëve të mëposhtme:

DISPOZITA PARAPRAKE

- A. Pala e Parë dhe Pala e dytë kanë shprehur vullnetin dhe interesin e tyre për realizimin e një ndërtimi të një kompleksi vilash e apartamentesh në objektin: "Kompleksi Turistik 'Gone-Perivol' me vendndodhje në Bashkinë Himarë" (Kompleksi Turistik) për të cilin, në emër të Shoqërisë "CONCORD INVESTMENT" shpk, është lëshuar leja e ndërtimit Nr. 615/15 Prot, datë 28.06.2021, sipas vendimit Nr. 26, datë 14.10.2020 të Këshillit Kombëtar të Territorit.
- B. Duke qenë se Investitor/Zhvillues i ndërtimit të cituar në pikën 1 është Shoqëria "Concord Investment shpk, Pala e parë dhe Pala e Dytë, pas nënshkrimit të kësaj Kontrate dhe



A.202105386007962587



regjistrimit të Shoqërisë së re të krijuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, do të lidhin një kontratë sipërmarrje me "Concord Investment" shpk me qëllim formalizimin e pozicionit të saj si subjekt ndërtues/investitor i Kompleksit Turistik cituar në pikës A më lart. Pas nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes, Shoqëria e re do jetë përgjegjëse për financimin dhe ndërtimin e këtij Kompleksi, duke marrë përsipër, si subjekt ndërtues investitor i këtij Kompleksi, përveç të tjerash, realizimin e investimit, ndërtimit, zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe shlyerjen e të gjitha detyrimeve ndaj shtetit për tatimet e taksat e aplikueshme dhe ndaj të tretëve.


C. Pala e Parë dhe Pala e Dytë, së bashku, do kryejnë hapat dhe procedurat e kërkuara që Shoqëria e Thjeshtë e krijuar sipas kësaj Kontrate të regjistrohet zyrtarisht në QKB. .

D. Ortakët Themelues dëshirojnë të rregullojnë mes tyre marrëdhënien e investimit në kuadër të një Shoqërie të Thjeshtë, duke përcaktuar të drejtat dhe detyrimet, si edhe mjetet që do të vendosin në dispozicion të Shoqërisë, në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate dhe të Kodit Civil që rregullojnë një kontratë dhe funksionimin e një shoqërie të tillë.

KREU I QËLLIMI DHE AFATI


NENI I QËLLIMI

1. Qëllimi i kësaj Kontrate është krijimi i Shoqërisë së Thjeshtë me emrin "ALBA-INVEST" (Shoqëria e Thjeshtë), nga Ortakët/Anëtarët Themelues, "ALBA BETON" shpk dhe "BABASI COO" shpk, me adresë Rr: "Përlat Rexhepi" Nd. 1, H.14, NJA 5, Tiranë, për ushtrimin e aktivitetit tregtar të investimit dhe ndërtimit të objektit "Kompleks Turistik 'Gone-Perivol' me vendndodhje në Bashkinë Himarë", sipas projektit të miratuar dhe lejes së ndërtimit, dhënë në emër të Shoqërisë "CONCORD INVESTMENT" shpk, Nr. 615/15 Prot, datë 28.06.2021, sipas vendimit Nr. 26, datë 14.10.2020 të Këshillit Kombëtar të Territorit, me mjetet e tyre financiare, në përputhje me këtë kontratë dhe kontrata të tjera që mund të lidhen në zbatim të saj, duke marrë përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lindin nga zbatimi i lejes së ndërtimit, si edhe realizimin e një fitimi me anë të shitjes së sipërfaqeve ndërtimore takuese të Shoqërisë, duke kryer ndarjen e fitimit, por edhe humbjes apo shpenzimeve në raport me përqindjen takuese të kontributit e parashikuar në këtë kontratë. Shoqëria e Thjeshtë merr përsipër gjithashtu, në funksion të aktivitetit të saj, shlyerjen paraprakisht të të gjitha detyrimeve ndaj organeve shtetërore, që përfshijnë, por pa u kufizuar, tatime e taksat e aplikueshme, çdo detyrim ndaj palëve të treta me të cilët do krijohen marrëdhënie kontraktuale pas krijimit të Shoqërisë etj.
2. Shoqëria e re e krijuar është e tipit Shoqëri e Thjeshtë dhe rregullohet nga kjo kontratë, që përbën edhe statutin e Shoqërisë, si edhe dispozitat e Kodit Civil, konkretisht nenet 1074 – 1112 të Kodit Civil. Shoqëria e Thjeshtë do të regjistrohet në organet tatimore në përputhje me legjislacionin në fuqi. Nëse zgjerohet objekti i kësaj Kontrate, Palët bien dakord për përcaktimin me konsensus të kushteve të reja që mund të krijohen, të cilat do të dakordësohen me shkrim.
3. Anëtarët themelues të Shoqërisë së Thjeshtë, bien dakord paraprakisht që të nënkontratojnë, me miratimin rast pas rasti të Shoqërisë "Concord Investment" shpk, zbatimin/ndërtimin e projektit



A2021053660079625872

duke lidhur kontrata sipërmarrje përkatëse për këtë qëllim dhe duke patur parasysh se ndërtimi do të kryhet në përputhje me projektin, grafikun e punimeve dhe preventivin që do miratohet. Nënkontraktimi do realizohet nëpërmjet një procedure prokurimi që do ndiqet rast pas rasti, në marrësi të llojit të punimeve dhe furnizimeve. Në përfundim të procedurës së prokurimit, Asambleja e Shoqërisë së Thjeshtë, në përputhje me vendimmarrjen e përcaktuar në këtë Kontratë, do vendosë për sipërmarrësin me të cilin do lidhet kontrata e nënkontraktimit, duke marrë paraprakisht edhe miratimin e Shoqërisë "Concord Investment" shpk.



NENI 2 KOHEZGJATJA

1. Kohëzgjatja e Shoqërisë së Thjeshtë është e barabartë me kohën e nevojshme për realizimin e investimit, përfundimin e ndërtimit të Kompleksit Turistik, dorëzimin e tij te Investitori, Shoqëria "Concord Investment" shpk, shitjen e njësive ndërtimore takuese të Shoqërisë "ALBA INVEST" pas regjistrimit të tyre në ASHK, shlyerjen e gjithë detyrimeve ndaj shtetit, shlyerjen e nënkontraktorëve si dhe kreditorëve të tjerë, nëse do ketë.
2. Ortakët themelues të Shoqërisë së Thjeshtë, pas regjistrimit të objektit dhe njësive ndërtimore të tij në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, nëse bien dakord apo vendoset nga Asambleja e Shoqërisë dhe pasi të jenë shlyer të gjitha detyrimet ndaj të tretëve, siç përcaktohet në pikën 1 të këtij neni, mund të ndajnë mes tyre pjesët takuese të mbetura pa shitur në përputhje me përqindjen takuese të përcaktuar në nenin 3 më poshtë, apo për të cilat nuk është lidhur kontratë porosie me të tretë dhe të prishin me marrëveshje Shoqërinë e Thjeshtë, pa pritur përfundimin e shitjeve të të gjitha njësive ndërtimore të Kompleksit Turistik.

KREU II FINANCIMI I AKTIVITETIT TË SHOQËRISË, KONTRIBUTET DHE MARRËDHËNIA FINANCIARE

NENI 3 KONTRIBUTET

1. Ortakët themelues të kësaj Shoqërie të Thjeshtë kontribuojnë në këtë investim për përballimin e shpenzimeve dhe të kostove për realizimin e objektit të aktivitetit të Shoqërisë së Thjeshtë, në raportet e investimit si më poshtë vijon:
 - a. **Pala e parë, Shoqëria "Alba Beton" shpk**, do të kontribuojë me **51% (pesëdhjetë e një përqind)** të të gjithë investimit.
 - b. **Pala e dytë, "Babasi COO"**, do të kontribuojë me **49% (dyzet e nëntë përqind)** të të gjithë investimit.

Palët/ortakët themelues të Shoqërisë bien dakord që fitimi ndahet midis ortakëve themelues vetëm pas shlyerjes së gjithë detyrimeve ndaj shtetit, nënkontraktorëve apo kreditorëve të tjerë nëse do ketë.

2. Kontributet e ortakëve mund të jenë para dhe mall dhe i dorëzohen Shoqërisë, e cila mban kontabilitetin e saj të veçantë. Kontributi në mall pranohet vetëm me miratimin e vendimit të Asamblesë sipas mënyrës së vendimmarrjes përcaktuar në këtë Kontratë, e cila përcakton edhe vlerën



K00110338600*961381

e këtij kontributi. Për kontributin në para. Shoqëria do krijojë një buxhet paraprak për financimin e projektit në përputhje me përqindjet takuese të secilit anëtar/ortak dhe vendimin e Asamblesë që do merret për këtë qëllim me jo më pak se 51% të kuotave. Pjesët që u takojnë ortakëve themelues në para ose në humbje, janë në raport të drejtë me përqindjet takuese të secilit prej tyre në Shoqërinë e Thjeshtë. Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100'000 lekë, nga të cilat 51'000 lekë kontribut i "Alba Beton" shpk, kurse 49'000 lekë kontribut i "Babasi COO" shpk.



Raporti i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni mund të ndryshojë vetëm nëse:

- a) Palës së Parë i kalojnë kuotat e Palës së Dytë vullnetarisht dhe anasjelltas.
- b) Njëra nga palët nuk përmbush detyrimin, në përputhje me përqindjen e saj takuese, për krijimin e buxhetit paraprak, sipas vendimit të Asamblesë që do të merret për këtë qëllim me 51% të kapitalit, apo shtimit të këtij buxheti rast pas rasti me qëllim financimin e ndërtimit. Për ta qartësuar, nëse vetëm njëra palë përmbush detyrimin për shtimin e buxhetit paraprak, apo shuma e kontribuar prej saj është më e madhe sesa ajo e palës tjetër, edhe përqindja takuese e tyre në Shoqëri në ndarjen e fitimit do të ndryshojë në favor të kësaj pale.
- b) Të dy së bashku, në përputhje me vendimin e Asamblesë marrë me 51% të kuotave, ia kalojnë një pjesë të kuotave një personi të tretë pas rishikimit të kësaj Kontrate.
- c) Kuotat apo një pjesë e kuotave të njëres palë, vetëm me pëlqimin e palës tjetër, i kalohen një të treti pas rishikimit të kësaj Kontrate.

4. Ndryshimi i përqindjes takuese të palëve sipas pikës 3/b të këtij neni, do të ndodhë në rastin kur njëra palë nuk depoziton vlerën financiare të kontribuar nga pala tjetër brenda 90 ditësh nga dita që kjo e fundit ka shtuar vlerën e saj të kontributit për financimin e Kompleksit Turistik nga ana e Shoqërisë së Thjeshtë.

5. Në rast ndërprerje të investimit nga njëra palë dhe zgjidhje të kësaj Kontrate/prishje të Shoqërisë së Thjeshtë, pala që ndërpret investimin ka të drejtën e shpërblimit me sipërfaqe ndërtimore, pas përfundimit të Kompleksit objekt Kontrate, të vlerës së kontribuar prej saj në raport me përqindjen e ndryshuar që zë kontributi i saj në vlerën totale të investimit, e përlogaritur me çmimin e shitjes të vendosur nga Asambleja për njësitë ndërtimore të Kompleksit, përveç nëse të dy Palët bien dakord ndryshe me shkrim. Në këtë rast, Investimi/ndërtimi do vazhdohet vetëm nga njëra palë, pa përjashtuar të drejtën e saj për të bashkëpunuar me investitorë apo subjekte ndërtues të tjerë. Ky rregull zbatohet në çdo rast të largimit të njëres palë nga investimi/Shoqëria e Thjeshtë apo zgjidhje Kontrate/prishje e Shoqërisë së Thjeshtë, në përputhje me rastet e parashikuara në këtë Kontratë dhe/ose vendim-marrjen e Asamblesë së Ortakëve me një shumicë prej 51% të kapitalit.

NENI 4

INVESTIMI DHE MARRËDHËNIA FINANCIARE

1. Anëtarët themelues bien dakord të bashkëpunojnë dhe të financojnë bashkarisht aktivitetin e Shoqërisë, duke krijuar një buxhet paraprak për fillimin e investimit dhe rritjen e këtij buxheti për vazhdimin e investimit, duke qenë të vetëdijshëm për vlerën e investimit sipas preventivit. Ata do të vënë në dispozicion të qëllimit të Shoqërisë të gjitha mjetet financiare dhe burimet njerëzore të



A202107386607962587

nevojshme për përbushjen e objektit të Shoqërisë, duke përfshirë, por pa u kufizuar në to:


- a) Financimin e ndërtimit dhe realizimin/zbatimin e tij nëpërmjet nënkontraktorëve që do të caktohen rast pas rasti me aprovimin e "Concord Investment" shpk. në përputhje me këtë Kontratë dhe vendimin e Asamblesë së Ortakëve, si edhe realizimin e shitjeve të njësisve ndërtimore takuese të Shoqërisë së Thjeshtë pas regjistrimit të tyre në ASHK, duke arkëtuar të ardhurat në një llogari bankare të përbashkët të dy ortakëve themelues, si edhe duke ndarë detyrimet ndaj shtetit dhe palëve të treta, si edhe çdo fitim apo e humbje në përputhje me përqindjen e tyre takuese në Shoqërinë e Thjeshtë. Nëse investimi i ndërtimit nga Shoqëria Alba Invest nuk vazhdon/përfundon, për çfarëdo arsye, përpara përbushjes së qëllimit të përcaktuar në këtë Kontratë, Shoqëria Alba Invest ka të drejtën e shpërblimit, pas përfundimit të Kompleksit, me sipërfaqe ndërtimore, sipas çmimit të miratuar për njësitë ndërtimore, në përputhje me vlerën e situacioneve të pranuarra deri në momentin e ndërprerjes, në përputhje edhe me Kontratën që do lidhet me "Concord Investment" shpk, e cila ka të drejtë të përzgjedhë një subjekt tjetër për vazhdimin e investimit/ndërtimit.
- b) Administrimin e marrëdhënieve me organet e shtetit dhe shlyerjen e të gjitha detyrimeve financiare dhe ligjore që burojnë nga leja e ndërtimit si edhe hapat që e pasojnë atë.

L1. Mospërbushja e detyrimit nga nga njëra palë për arkëtimin në llogarinë bankare të Shoqërisë të pjesës së saj takuese brenda 60 ditësh nga dita e vendimit, në përputhje me vendimin e Asamblesë së Shoqërisë së Thjeshtë për masën e buxhetit paraprak, si edhe shtimin e këtij buxheti rast pas rasti për vazhdimin e investimit, përbën shkak për uljen e përqindjes takuese të palës, e cila nuk plotëson vlerën e saj financiare sipas përqindjes takuese të vendosur paraprakisht. Ky fakt, bazuar në përlllogaritjet rast pas rasti, mund të konfirmohet me marrjen e vendimit nga Asambleja e Shoqërisë me jo më pak se 51% të kuotave.

2. Ortakët themelues, si rezultat i pjesëmarrjes në Shoqërinë e Thjeshtë, në përputhje me objektin e përcaktuar më lart, bien dakord që, në rast të mos ndryshimit të përqindjeve takuese siç parashikohet më lart në këtë Kontratë, pas shitjeve të njësisve ndërtimore takuese sipas kësaj Kontrate, Pala e Dytë do të shpërblehet me 49% (dyzetë e nëntë përqind) të pjesës takuese ndërtimore të Shoqërisë së Thjeshtë, kurse Pala e Parë me 51% (pesëdhjetë e një përqind), pasi të jetë përcaktuar e shlyer më parë çdo detyrim ndaj palëve të treta, siç citohet në dispozitat e kësaj kontrate, përfshirë detyrimet ndaj organeve shtetërore. Palët bien dakord se nuk do të ngrenë në të ardhmen pretendime shtesë që bien ndesh me çfarë dakordësohet në këtë Kontratë që përbën statutin e Shoqërisë.


3. Palët bien dakord që të gjitha pagesat e të ardhurave nga shitja apo kontratat e porosisë që mund të lidhen në përputhje me këtë Kontratë dhe kontratën që do të lidhet me Shoqërinë "Concord Investment" shpk, do të derdhen në llogarinë bankare të hapur nga palët në emër dhe për llogari të Shoqërisë së Thjeshtë. Të gjitha pagesat do të vërtetohen me mandat/statement. Këto të ardhura do të menaxhohen në përputhje me këtë Kontratë, duke patur në konsideratë fillimisht shlyerjen e detyrimeve tatimore ndaj organeve shtetërore, si edhe shlyerjen e detyrimeve të Shoqërisë ndaj palëve të treta kreditore.

4. Vlera totale e investimit do të llogaritet sipas zërave të punimeve që përfshijnë veç të tjerash edhe punimet e gërmimit, rrethimit, përgatitjes së kantierit dhe lidhjet me infrastrukturën (kanalizimet, ujin,



A2001073660079625870

energjinë elektrike, rrugët etj), ndërtimin e karabinasë, kondicionimin, rifiniturat dhe çdo detaj tjetër sipas Projektit të miratuar dhe nevojave të funksionimit të Kompleksit Turistik, në përputhje me Projektivin dhe grafikun e punimeve të miratuar nga Palët, siç është përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.



KREU III FUNKSIONIMI I SHOQËRISË DHE VENDIM-MARRJA

NENI 5 FUNKSIONIMI I SHOQËRISË DHE ORGANET DREJTUESE

1. Forma e Shoqërisë është ajo e një Shoqërie të Thjeshtë, e cila do të regjistrohet në organet tatimore në përputhje me legjislacionin në fuqi. Shoqëria do të funksionojë sipas dispozitave të kësaj Kontrate, si edhe në neneve 1074 e vijim të Kodit Civil të Shqipërisë.


2. Organet Drejtuese të Shoqërisë janë:

- a. Asambleja e Përgjithshme përbëhet nga dy shoqëritë (ortakët) themelues, përfaqësuar respektivisht nga ortakët e secilës. Ortakët e secilës prej shoqërive themeluese mund të përfaqësohen edhe nga një prej ortakëve të secilës Shoqëri themeluese. Kryetar i Asamblesë është përfaqësuesi i Shoqërisë "Alba Beton" shpk në Asamble. Z. Adrian Dulaku, në pozitën e një prej ortakëve të anëtarit/ortakut themelues që ka shumicën;
- b. Administratori

3. Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme, përveç çfarë përcaktohet specifikisht në dispozitat e kësaj Kontrate, ka kompetencë për:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin/shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin/shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për administratorët, ekspertët kontabël të autorizuar dhe likuiduesit.
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) miratimin e një buxheti paraprak për fillimin e investimit, sipas pikës 1 të nenit 4 të kësaj Kontrate, si edhe zmadhimin/zvogëlimin e kapitalit;
- f) përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- g) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) pranimin e një apo disa ortakëve të rinj, nëse do jetë rasti;
- i) marrjen kredi apo hua dhe vendosjen e kolateralit përkatës;
- j) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- k) miratimin e nënkontraktorëve për punime/furnizime dhe miratimin e kontratave të sipërmarrjes që do lidhen sipas vlerës së caktuar për zëra punimesh apo furnizimesh për vlera mbi 50'000 Euro, ose vlera barazvlefshme në lekë sipas kursit të këmbimit;



ALB01303860079625871

I) miratimin e preventivit të punimeve dhe ndryshimeve të mundshme të tij, si edhe miratimi i çmimeve për zërat e punimeve pas kryerjes prej saj të procedurave të prokurimit për punime dhe shërbime të miratuara paraprakisht nga "Concord Investment" shpk;

II) miratimin e një shoqërie për mirëmbajtjen dhe administrimin e pjesëve të përbashkëta të Kompleksit të Zgjedhja e supervizorit/mbikëqyrësit të punimeve dhe personit që pranon/nënshkruan situacionet mujore të nënkontraktorëve nga propozimet që do jepen nga Pala E Parë;

III) përfshirje të tjera të parashikuara nga ligji apo kjo Kontratë që përbën statutin e Shoqërisë.

4. Asnjë nga palët nuk ka të drejtë të kryejë transferimin, totalisht ose pjesërisht, të kuotave/përqindjes së saj faktuese në Shoqërinë e Thjeshtë, duke përfshirë, shitjen, dhurimin, dhënie me qira etj, të të tretë. Çdo transferim kuotash, pjesërisht ose totalisht, i cfarëdolloji qoftë, i kryer nga secila palë konsiderohet si vullnet i saj për t'u larguar nga Shoqëria e Thjeshtë, duke sjellë si pasojë zgjidhjen automatikisht të kësaj Kontrate dhe prishjen e Shoqërisë së Thjeshtë "Alba Invest".

4.1. Në rast të shitjes/transferimit të më shumë se 29% të kuotave/kapitalit të secilës palë brenda ortakëve të shoqërive të tyre, pala që ndodhet para këtij fakti ka detyrimin të marrë miratimin/aprovimin e palës tjetër për këtë transakcion. Çdo veprim i kryer në mosrespektim të kësaj pike i jep të drejtë palës tjetër të zgjidhë këtë Kontratë në mënyrë të njëanshme, duke sjellë si pasojë prishjen e Shoqërisë së Thjeshtë.

5. Në rast prishje të Shoqërisë së Thjeshtë, ajo do të likuidohet me vlerën e investimit të kryer deri në atë moment, referuar situacioneve të miratuara nga "Concord Investment" shpk. Likuidimi do jetë me sipërfaqe ndërtimore në përfundim të ndërtimit sipas çmimit të vendosur për njësi ndërtimore nga "Concord Investment" shpk.

6. Vendim-marrja në Shoqërinë e Thjeshtë do konsiderohet e vlefshme nëse vendimet miratohen me një shumicë të barabartë me jo më pak se 51% të kapitalit të Shoqërisë, kur nuk është e mundur që vendimet të merren në mënyrë unanime. Për qartësi, kapitali i Shoqërisë së Thjeshtë përbëhet nga dy kuota, njëra në masën 51% e zotëruar nga Pala e Parë, Shoqëria "Alba Beton" shpk, dhe tjetra në masën 49%, e zotëruar nga Pala e Dytë, Shoqëria "BABASI COO" shpk. Pavarësisht se të dyja këto shoqëri, në pozitën e ortakëve themelues të Shoqërisë së Thjeshtë "ALBA INVEST", zotërohen secila nga disa ortakë. Ilogaritja e përqindjes për efekt vendim-marrje në Shoqërinë e Thjeshtë, sipas kësaj Kontrate, do i referohet vendim-marrjes së dy shoqërive sipas vendimeve të asamblesë përkatëse dhe jo përqindjes takuese të secilit prej këtyre ortakëve në shoqëritë respektive. Pra, një vendim, që të konsiderohet i vlefshëm dhe të prodhojë pasoja juridike, do konsiderohet i marrë nëse miratohet unanimisht nga asambletë e përgjithshme të secilës prej shoqërive, ose nëse merret nga asambleja e përgjithshme e Shoqërisë "Alba Beton" shpk. Çdo interpretim tjetër që bie në kundërshtim me këtë qartësim, do konsiderohet i bërë në keqbesim dhe nuk do ketë asnjë pasojë juridike.

7. Kontabilisti/Eksperti Kontabël i Shoqërisë zgjidhet me pëlqimin dhe miratimin e të dy ortakëve themelues. Nëse Palët nuk bien dakord, ai caktohet me vendimin pro të 51% të kuotave. Kontabilisti i



A202107386007961871

shoqërisë, në fund të çdo muaji, i dorëzon të dy ortakëve themelues, një raport të plotë mujor mbi

çështjet e lidhura me aktivitetin e shoqërisë dhe gjendjen financiare të Shoqërisë, më saktësisht:

Raportin e detajuar mbi ecurinë e aktivitetit;

Raportin financiar, mbi gjendjen e librave të arkës së shitjeve dhe të blerjeve;

Raportin shpjegues për mospërputhje thelbësore lidhur me raportet financiare;

Masat që do të merren për parandalimin apo rregullimin e mospërputhjeve të mundshme;

Detyrimet ndaj organeve shtetërore apo palëve të treta të mundshme.

Secili prej ortakëve themelues, mund të konsultohet me kontabilistin dhe dokumentat financiare në çdo kohë, për të mundësuar që secili prej tyre të marrë informacion të plotë mbi çështjet e lidhura me aktivitetin e Shoqërisë. Çdo ortak/anëtar ka të drejtë të marrë pjesën e vet të investimit në natyrë, e cila është e barabartë me përqindjen e kontributeve që ka derdhur secili, të përcaktuara paraprakisht nga projekti përfundimtar i miratuar nga lejet përkatëse të ndërtimit. Në rast tërheqje nga investimi apo prishje të Shoqërisë së Thjeshtë përpara afatit, siç parashikohet në dispozitat e kësaj Kontrate. Pala e Dytë do të marrë vetëm pjesën që ka investuar deri në atë moment.

NENI 6

DETYRIMET E ORTAKËVE

1. Secili prej ortakëve themelues do të ushtrojë të drejtën e tij të votës në Shoqëri dhe pranon të gjitha të drejtat dhe detyrimet ndaj Shoqërisë, të përcaktuara në këtë Kontratë dhe të tjera që mund të lindin në funksion të përmbushjes së qëllimit të saj, apo përcaktohen si të tilla nga legjislacioni në fuqi.


2. E drejta e përfaqësimit të Shoqërisë së Thjeshtë për të gjitha veprimet që përfshihen në arritjen e qëllimit të saj, nëse nuk përcaktohet ndryshe në dispozitat e tjera të kësaj Kontrate apo në vendime të posaçme të Asamblesë së Ortakëve, i takon Administratorit, në përputhje me tagrat e tij, ose të dy ortakëve themelues së bashku ose çdo ortaku veçmas, nëse ai vepron në emër të Shoqërisë dhe nëse është i autorizuar të përfaqësojë atë, referuar mënyrës së vendim-marrjes të përcaktuar në këtë Kontratë.

NENI 7

ADMINISTRATORI


Ortakët themelues miratojnë në unanimitet si administrator të kësaj Shoqërie të Thjeshtë Z. Erjon Harizi. Afati i qëndrimit në detyrë të Administratorit është 1 vit nga dita e nënshkrimit të kësaj Kontrate. Me vendimin e Asamblesë së Shoqërisë të marrë me jo më pak se 51% e kuotave, ky afat mund të shtyhet. Përveç nëse vendoset ndryshe me vendim të Asamblesë së Ortakëve, kompetencat e tij konsistojnë në pikat si më poshtë.

- Administratori drejton veprimtarinë e përditshme të Shoqërisë, duke patur të drejtë ta përfaqësojë Shoqërinë e Thjeshtë me të tretët dhe të kontraktojë në emër të saj për të fituar të drejta apo për të



A2021073860070625870

marrë përsipër detyrime brenda kufizimeve të objektit të veprimtarisë të Shoqërisë dhe tagrave të tij, në përputhje me këtë Kontratë dhe me Vendimet e Asamblesë.



Administratori kufizohet në kryerjen e veprimeve të tij, duke mos patur të drejtën e kryerjes së veprimeve/transaksioneve të blerjes apo lidhjes së kontratave me vlerë më të lartë se 50'000 Euro. Njëta vlerë në lekë sipas kursit të këmbimit, përveç nëse ka një vendim të asamblesë së ortakëve të marrë në përputhje me këtë Kontratë. Për veprime mbi këtë vlerë, nëse nuk ka një vendim Asambleje, çdo veprim/transaksion/kontratë do të jetë i vlefshme nëse nënshkruhet edhe nga një prej ortakëve të Palës së Parë, të ndryshëm nga administratori, dhe konkretisht, Kryetari i Asamblesë, Z. Adrian Dulaku.


- Administratori ka të drejtë të kryejë administrimin e zakonshëm të Shoqërisë, të ndjekë kryerjen e punimeve dhe cilësinë e tyre, personalisht apo nëpërmjet përfaqësuesve të tij, duke bashkëpunuar me supervizorin dhe persona të tjerë të caktuar për kontrollin e punimeve, verifikimin dhe nënshkrimin e situacioneve dhe ecurinë e ndërtimit në përgjithësi, si edhe duke iu referuar dokumentacionit përkatës, dhe duke u kujdesur në mënyrë që të respektohen kontratat e sipërmarrjes për zbatimin e projektit dhe të përmbushen të gjitha kushtet e tyre.
- Administratori ka detyrimin të ndjekë dhe zbatojë vendimet e ortakëve themelues që i shtojnë apo pakësojnë tagrat e përfaqësimit rast pas rasti, si edhe çdo vendim tjetër të marrë nga Asambleja. Vendimi në këtë rast merret me 51% të kapitalit të Shoqërisë.
- Administratori ka të drejtën të autorizojë avokatë, ekspertë etj. për të përfaqësuar çështje në gjykatat e të gjitha shkallëve, në të gjitha pozicionet procedurale ku janë në shqyrtim interesa të drejtëpërdrejta ose të tërthorta që prekën këtë investim dhe Shoqërinë e thjeshtë, duke njoftuar rast pas rasti ortakët themelues.
- Administratori bashkëpunon me revizorë, supervizorë, kofaudatorë, ekspertë kontabël etj., të caktuar, rast pas rasti, nga Pala e Parë apo sipas vendimit të Asamblesë së ortakëve të marrë me jo më pak se 51% e kapitalit, për të realizuar dhe mbrojtur të drejtat dhe interesat e Shoqërisë.
- Administratori dhe një nga ortakët e Palës së Parë kanë të drejtë të nënshkruajnë kontratat me nënkontraktorët si edhe kontratat e shitjes së njërive ndërtimore.

NENI 8

A. Ndërtimi i objektit

I. Ndërtimi i Objektit do të kryhet në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, preventivin, grafikun e punimeve dhe çdo dokument tjetër në funksion të tyre, përfshirë, këtë Kontratë, dhe kontratat që Shoqëria "ALBA INVEST" do lidhë me nënkontraktorët sipas furnizimeve dhe punimeve specifike të nevojshme për përfundimin e Kompleksit Turistik. Shlyerja e nënkontraktorëve nga Shoqëria e Thjeshtë me klering do të quhet investim i të dy ortakëve themelues në përputhje me përqindjen e tyre takuese 51% - "Alba Beton" shpk dhe 49% - "Babasi Co" shpk.

Palët bien dakord se sipërfaqja ndërtimore e projektit të miratuar, nëse konsiderohet e arsyeshme dhe miratohet nga organet kompetente, mund të ndryshojë, duke e pasqyruar këtë ndryshim, nëse ndodh, në këtë Kontratë, duke marrë edhe miratimin e Shoqërisë "CONCORD INVESTMENT" shpk.



A2001053860079625972

2. Administrimi i shitjes së sipërfaqeve ndërtimore që do të përftohet nga ndërtimi dhe i të ardhurave përkatëse kryhet nga Shoqëria e Thjeshtë, nepërmjet Asamblesë së Shoqërisë në përputhje me dispozitat e vendim-marrjes të përcaktuara në këtë Kontratë dhe çmimin e shitjes së miratuar nga Asambleja me jo më pak se 51% të kuotave.

B. Marrëdhëniet me të tretët (insitucione shtetërore, bankare etj)

Marrëdhëniet me të tretët në kuadrin e paragrafëve të këtij neni, do të mbahet nga Shoqëria e Thjeshtë nepërmjet Administratorit ose një personi të autorizuar nga Asambleja, sipas tagrave dhe kushteve të tij, duke përfshirë edhe marrëdhëniet me institucionet shtetërore, si Organet Tatimore, Organet e Përshtetit Vendor, Bankat, Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme etj.

C. Vendimmarrja

Vendimet do të merren me mirëkuptimin dhe miratimin e të dy palëve/anëtarëve themelues. Kur Palët nuk bien dakord për marrjen e vendimeve me unanimitet, çdo vendim quhet i miratuar me votën pro të 51% të kuotave/kapitalit të Shoqërisë, bazuar në përqindjet takuese të shoqërive të përcaktuara më lart. Për situata/çështje të papërcaktuara në këtë Kontratë, ortakët themelues do vendosin rast pas rasti në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate në lidhje me vendim-marrjen.

KREU IV

ZGJIDHJA E MARRËDHËNIES DHE PRANIMI I ORTAKUT TË RI

NENI 9

ORTAKU I RI

Ortakët e rinj në Shoqërinë e Thjeshtë mund të pranohen vetëm me vullnetin e përbashkët të të dy ortakëve themelues dhe në përputhje me vendimin e Asamblesë së Shoqërisë.


KREU V

SHËRNDARJA DHE LIKUJDIMI

NENI 10

SHËRNDARJA

1. Shoqëria shpërndahet me realizimin e objektit të shoqërisë, si edhe shlyerjes së detyrimeve ndaj shtetit dhe të tretëve dhe shpërndarjes së fitimit në përputhje me përqindjen takuese të secilit prej ortakëve.
2. Shoqëria përfundon me largimin e një ortaku sipas kushteve të kësaj Kontrate.
3. Kur Asambleja e Ortakëve themelues përcakton me 51% të kapitalit pamundësinë e realizimit të investimit Objekt i Shoqërisë së Thjeshtë.
4. Shoqëria përfundon para afatit me vullnetin e përbashkët të ortakëve.
5. Për çdo arsye tjetër të përcaktuar në këtë Kontratë.



A2021033860079613871



NENI 11 LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Likuidimi i shoqërisë bëhet nga vetë ortakët me marrëveshje ose likujdues të përcaktuar me marrëveshje midis ortakëve në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate.

Likujduesi ose likujduesit marrin në dorëzim sendet dhe dokumentat e shoqërisë dhe hartojnë, së bashku me ortakët, inventarin që përcakton gjendjen aktive dhe pasive të shoqërisë. Inventari nënshkruhet nga ortakët dhe likujduesi ose likujduesit.

3. Në rradhë të parë, likujduesi ose likujduesit rregullojnë marrëdhënien me pronarët e truallit si dhe paguajnë kreditorët e tjerë të shoqërisë, nëse këta nuk janë shlyer, siç përshkruhet në dispozitat e kësaj Kontrate.
4. Aktivi i mbetur pas shlyerjes së kreditorëve, përdoret në rradhë të dytë për të rregulluar marrëdhëniet midis ortakëve.

NENI 12 SHITJA E SIPËRFAQEVE NDËRTIMORE

1. Anëtarët e kësaj Shoqërie të Thjeshtë, vendosin që vlerat e çmimit të shitjes për metër katror sipërfaqe ndërtimi, sipas destinacionit të sipërfaqes, do të miratohet me vendim të Asamblesë së Shoqërisë, e cila ka të drejtën për të vendosur, analizuar dhe rishikuar çmimin, në varësi të ecurisë të çmimeve të tregut dhe pa konkuruar dhe pa rënë ndesh me çmimet e vendosura nga Concord Investment shpk. Çdo shitje/premtim shitje/kontratë porosie e sipërfaqeve ndërtimore do të bëhet vetëm me miratimin me shkrim të "Concord Investment" shpk deri në momentin e kalimit në pronësi të Shoqërisë "Alba Invest" shpk të sipërfaqeve ndërtimore takuese të saj nga ana e Concord Investment, në përputhje me investimin e kryer në ndërtimin e Kompleksit dhe me kontratën e sipërmarrjes që do lidhet ndërmjet Alba Invest dhe Concord Investment.
2. Kontratat e shitjes (pas regjistrimit të pjesëve takuese në ASHK)/premtim shitje/porosisë të sipërfaqeve ndërtimore takuese të Shoqërisë së Thjeshtë do të nënshkruhen nga Administratori dhe Kryetari i Asamblesë së Përgjithshme, Z. Adrian Dulaku. Kontratat që nuk nënshkruhen siç përcaktohet në këtë pikë janë të pavlefshme.

NENI 13 FORCA MADHORE

Asnjëra nga palët nuk mban përgjegjësi për moszekutimin e plotë apo të pjesshëm të detyrimeve që rrjedhin nga kjo kontratë, kur kjo gjë ka ardhur si pasojë e forcave madhore ashtu siç përcaktohet nga ligji, për aq sa ajo forcë madhore ndikon drejtpërdrejt në qëllimin e Shoqërisë.

Në ngjarjet e forcës madhore përfshihen revolucionet, luftat, grevat, zjarret, përmbajtje.

Nuk do të konsiderohen forca madhore, pezullimet, që kanë ardhur si rezultat i veprimeve apo mosveprimeve jo korrekte të Palës së Dytë me shtetin dhe persona fizikë apo juridikë.



A:021055860079605872

Palët janë të detyruara t'i njoftojnë njëra-tjetrës fillimin dhe përfundimin e Forcës Madhore brenda 3 (tre) muajve. Në këtë rast, Pala tjetër është e detyruar të shtyjë afatin e pagesave për aq kohë sa zgjat forca madhore.

Në rast se forca madhore zgjat më shumë se 3 (tre) muaj, atëherë secila palë mund të kërkojë rishikimin e kushteve të Marrëveshjes ose të tërhiqet prej saj. Në këtë rast, do të zbatohen dispozitat e parojave të zgjidhjes së Kontratës.

ANE

NENI 14

INTERPRETIMI I KONTRATËS NË TËRËSI

Çdo kusht apo formulim që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e terësisë së Kontratës së Shoqërisë së Thjeshtë dhe në këndvështrimin e qëllimit që i shtyu palët të lidhin këtë kontratë.

Në rast se një apo disa dispozita të kësaj kontrate do të konstatohen absolutisht të pavlefshme, relativisht të pavlefshme, të pa-ekzekutueshme dhe/ose të pazbatueshme, Palët në mirëbesim dhe me korrektësi karshi njëra-tjetrës do të bisedojnë për t'i zëvendësuar këto dispozita me të tjera, gjithmonë në përputhje me objektin e kësaj kontrate, që i shtyu të hyjnë në këtë marrëdhënie kontraktore.

NENI 15

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM DHE JURIDIKSIONI

Kjo Kontratë Shoqërie e Thjeshtë, është hartuar në bazë të legjislacionit shqiptar dhe konkretisht nenit 1074, e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë. Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin midis palëve gjatë zbatimit të kësaj kontrate, do të zgjidhen me tolerancë e mirëkuptim midis tyre, në të kundërt ato bien dakord të ngrenë një komision arbitrazhi të përbërë nga tre përfaqësues, nga një për secilën palë dhe një palë e tretë e pavarur dhe e përzgjedhur me miratimin e përbashkët të të dy palëve. Nëse palët nuk bien dakord në përzgjedhjen e palës së tretë të pavarur për një periudhë 60 ditore nga dita e konstatimit zyrtar të mosmarrëveshjes, ose nuk bien dakord me vendimin e komisionit sipas kësaj pike, kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 16


NJOFTIMET

Çdo njoftim, kërkesë apo çdo lloj komunikimi ndërmjet palëve do të bëhet me shkrim në adresat e përshkruara në këtë kontratë, duke pasur parasysh që të dërgohet sa më shpejt.

Palët zgjedhin adresat e mëposhtme për kryerjen e çdo komunikimi zyrtar në lidhje me sa parashikohet në këtë Kontratë. Njoftimet do të kryhen me shkrim dhe do t'i njoftohen Palëve në adresat e mëposhtme nëpërmjet letrës rekomande, me lajmërim marrje, fax ose email:

Erjon Harizi
Rr. Perlat Rexhepi

Ndriçim Babasi
Rr. "Rruga kombëtare Fushë-Krujë" --



A200105386007962582

11. 14. Ap. 7. NJA nr. 5, Tiranë

Krujë, km 2-të. Fushë-Krujë

Email: harizi@albabeton.com.al

Email: babasicoo@gmail.com



NENI 17

SHTESA DHE NDRYSHIMET NË KONTRATË

Kjo kontratë e Shoqërisë së Thjeshtë përbën marrëveshjen e plotë dhe të vetme mes Palëve, duke zëvendësuar çdo komunikim të mëparshëm. Ndryshimi i kësaj kontrate mund të kryhet vetëm me pëlqimin e të dy ortakëve themelues. Të gjitha shtesat dhe ndryshimet në këtë Kontratë, nuk do të kenë asnjë vlerë ligjore në qoftë se nuk janë miratuar dhe nënshkruar rregullisht nga të dyja palët.

Kjo kontratë e ruan fuqinë e saj ligjore dhe i shtrin efektet e saj edhe mbi trashëgimtarët e palëve kontraktuese apo të tretët, që mund të fitojnë të drejta reale mbi aktivitetin e tyre.

NENI 18

ANEKSET E KONTRATËS

Kësaj Kontrate i bashkëlidhen si pjesë përbërëse dhe të pandarë këto dokumenta që do të quhen Aneksë të kontratës. Në aneks të kontratës do të bëjë pjesë dokumentacioni shoqëruar i përbërë prej:

- Ekstraktet e dy Shoqërive dhe vendimet përkatëse të Asamblesë.
- Leja e Ndërtimit dhe projekti i miratuar i Objektivit në Palasë.

NENI 19

HARTIMI I KONTRATËS

Kjo kontratë përbëhet nga 19 (nëntëmbëdhjetë) nene dhe 13 (trembëdhjetë) fletë dhe përpilohet në 5 (pesë) kopje të barazvlershme, në gjuhën shqipe. Secila palë mban nga dy kopje, dy kopjet e tjera, një kopje depozitohet pranë QKB-së dhe një mbahet nga noterja.

PALËT THEMELUESE

PALA E PARE

Shoqëria "Alba Beton" shpk
ERJON HARIZI

ADRIAN DULAKU



PALA E DYTE

Shoqëria "Babasi Cao" shpk
NDRICIM BABASI

NOTERE

Mariana Daka

